Konklava e Fakultetit të Mjekësisë në Universitetin e Prishtinës

Raport përshkrues i procesit të përpilimit të provimeve pranuese në Fakultet të Mjekësisë për vitin akademik 2020/2021



Autorë:

Liridona Ademaj

Saranda Sylejmani

04 tetor 2020 (Një ditë para provimit pranues)

Nëse i afroheshe objektit të ri të dekanatit të Fakultetit të Mjekësisë, të jepte ndjesinë se diçka me të vërtetë e rëndësishme po ndodhte aty. Para derës së hyrjes kryesore shihej një patrullë e Policisë së Kosovës, disa hapa më tutje ishin edhe rojet e sigurisë së Fakultetit.



(Dy zyrtarë policorë të cilët qëndronin brenda objektit të Dekanatit të Fakultetit të Mjekësisë)

Kur kaloje dyert prej xhami, brenda ishte një aksion i vërtetë, të gjithë po merreshin me diçka dhe po vazhdonin konsultimet me njëri tjetrin, pra vëreheshin përgatitje për diçka të rëndësishme që pritej të ndodhte.



(Anëtarët e Komisionit për Provim Pranues teksa diskutojnë mes vete para fillimit të procesit)

Në anën e majtë të korridorit në katin e parë, ishin vendosur ulëse për organizatat monitoruese të këtij procesi (ORCA, BIRN dhe ADMOVERE). Pak më larg këtyre ulëseve ishin vendosur katër pajisje të mëdha për printim. Dy hapa më larg këtyre ulëseve me ngjyrë të zezë, shihej një sef çeliku rreth një metërsh me ngjyrë të bardhë.





(Foto1:Vendi ku ishin ulur organizatat monitoruese, Foto 2: Sefi ku mbaheshin telefonat celularë)

Në mes të korridorit ishte vendosur një tavolinë e gjatë mbledhjesh, në të cilën gjendeshin shtatë anëtarët e Komisionit të Provimit Pranues dhe dekanja e Fakultetit të Mjekësisë, Suzana Manxhuka-Kërliu.

Ndërkohë që në anën e djathtë ishin ulur ekipi nga Fakulteti Teknik, të cilët ishin pajisur me zhurmues të cilët mund të gjurmojnë dhe ndërpresin valët për pajisjet elektronike, si telefon, tabletë, laptop, kompjuterë, etj.



(Disa minuta para zhvendosjes së komisioneve në kabinete të ndara për përpilimin e pyetjeve)

Pasi u uroi mirëseardhje të gjithëve, pak minuta pas orës 18:00 u bllokuan edhe valët nga ekipi që kishte ftuar dekanja e Fakultetit të Mjekësisë, e cila më pas kërkoi nga të gjithë të pranishmit përfshirë edhe dy zyrtarëve policor që gjendeshin brenda sallës, që të bëjnë dorëzimin e telefonave në mënyrë që të vendosen në sef deri të nesërmen pas shpërndarjes së provimeve pranuese nga Policia e Kosovës nëpër sallat testuese. Ajo gjithashtu shtoi se askush nuk lejohet të largohet nga objekti deri në përfundim të procesit, e që nënkuptonte deri të nesërmen në mëngjes.

I gjithë ky proces të ngjasonte me Konklavën e Vatikanit në Romë, në të cilën kardinalët mbyllen brenda dhe nuk dalin me ditë të tëra deri në zgjedhjen e Papës së ri. Ashtu dukej edhe kjo mbyllje brenda Fakultetit të Mjekësisë.



(Dorëzimi dhe mbyllja në sef e telefonave celularë të të gjithë pjesëmarrësve në këtë proces)

Tutje u kërkua nga të gjithë të pranishmit që të bëjnë nënshkrimin e deklaratës së konfidencialitetit, përmes të cilës bëhej zotimi se asnjë informacion nuk do të diskutohej me palët e treta.



(Nënshkrimi i deklaratës së konfidencialitetit nga monitoruesja e BIRN, Arbisa Shefkiu)

Shumë shpejtë filloi edhe ndarja e komisioneve në dy kabinete të ndryshme, në njërën anë ishin profesorët që do të përpilonin pyetjet e biologjisë dhe në anën tjetër profesorët që do të përpilonin pyetjet e Kimisë.





(Në dy fotografitë gjenden anëtarët e dy komisioneve për përpilimin e pyetjeve nga Biologjia dhe Kimia)

Në orën 18:50, dekanja filloi të tregonte për traditën disavjeçare të përgatitjes së pyetjeve për provimin e përvitshëm pranues në Fakultetin e Mjekësisë, e që sipas saj, organizohej me qëllimin e vetëm që fakulteti të cilin ajo e drejton, të pranojë vetë studentët meritor.



(Dekanja e Fakultetit të Mjekësisë, Suzana Manxhuka-Kërliu dhe monitoruesja nga ORCA, Liridona Ademaj)

Nga dy anëtarë të Komisionit për Provim Pranues, ishin mbikëqyrës të dy komisioneve që përbëheshin prej tre anëtarësh, e që ishin angazhuar të përpilonin nga 25 pyetje për Biologji dhe 25 për Kimi.

Pyetjet ishin formuluar dhe nxjerrë nga librat e Biologjisë dhe Kimisë të klasës së 10, 11 dhe 12 të shkollës së mesme të lartë.


Dekanja e Fakultetit të Mjekësisë tha se falë kësaj tradite të krijimit të pyetjeve për provim pranues një ditë para testimit, Fakulteti i Mjekësisë vazhdon të ketë studentë meritor dhe më të përgatiturit në të gjithë Kosovën.

Në orën 19:30, në dekanat erdhi për vizitë rektori i Universitetit të Prishtinës, Naser Sahiti të cilit gjithashtu iu kërkua që ta bënte dorëzimin e telefonit gjatë kohës që do të qëndronte brenda objektit.



(Vizita e rektorit të Universitetit të Prishtinës, Naser Sahiti, i cili u prit nga dekanja, kryetari i Komisionit për Provim Pranues, Elton Bahtiri dhe sekretari i Fakultetit, Visar Muçaj)

Rektori përgëzoi punën e menaxhmentit të Fakultetit të Mjekësisë, të cilët sipas tij, çdo vit angazhohen për mbarëvajtje të procesit të përpilimit të pyetjeve për provime pranuese dhe mbikëqyrjes së tyre, duke shtuar se ky është një proces shumë i rëndësishëm i cili zvogëlon mundësinë për manipulim.





(Foto1:Deklarata e rektorit të UP-së për procesin e provimit pranues në Fakultet të Mjekësisë, Foto 2:Informim i rektorit të UP-së, rreth procesit të provimit pranues nga ana e dekanes dhe prodekanëve të Fakultetit të Mjekësisë)

Pas 20 minutash, rektori u largua nga dekanati dhe në orën 20:05, dekanja e këtij fakulteti filloi me nënshkrimin e 1721 fletë-provimeve pranuese në bashkëpunim me kryetarin e Komisionit për Provim Pranues, Elton Bahtiri dhe me sekretarin e fakultetit, Visar Muçaj, i cili i vuloste ato.



(Fillimi i procesit të nënshkrimit të fletë-provimeve pranuese nga dekanja dhe kryetari i Komisionit për Provim Pranues, si dhe vulosja e tyre nga sekretari i fakultetit)

Kryetari i Komisionit për Provime Pranuese, Elton Bahtiri tha se për këtë vit akademik Fakulteti i Mjekësisë ka 420 pozita të lira për studentët e ardhshëm. Për programin Mjekësi e Përgjithshme janë ndarë 150 vende, për Infermieri 100 vende, për Stomatologji 70 vende, për Farmaci 50 vende dhe për Fizioterapi 50 vende.

Tutje ai tregoi se konkurrenca më e madhe është në programet Mjekësi e Përgjithshme dhe Infermieri, duke sqaruar se në Fakultetin e Mjekësisë kanë qenë gjithsej 1722 kandidatë mirëpo një është diskualifikuar për arsye se ka falsifikuar dokumentet (suksesin e lëndëve në shkollë të mesme).



(Informimi i organizatave monitoruese ORCA dhe BIRN nga kryetari i Komisionit për Provim Pranues rreth numrit të pozitave për studentë dhe numrit të kandidatëve që kanë konkurruar)

Në orën 23:15 u bë edhe ndërrimi i zyrtarëve policorë, të cilët refuzuan që të bëjnë dorëzimin e telefonave, duke deklaruar se kishin marrë urdhër nga rreshteri.

Pas orës 23:30, pyetjet e përpiluara nga komisionet përkatëse, u sollën jashtë kabineteve për t'ua dorëzuar anëtarëve të Komisionit të Provimit Pranues, të cilët edhe filluan me përzgjedhjen e tyre.



(Fillimi i procesit të përzgjedhjes së pyetjeve nga Komisioni për Provim Pranues)

05 tetor 2020 (Dita e provimit pranues)

Pas diskutimeve të shumta, kjo përzgjedhje u përmbyll në orën 01:15 duke vazhduar me verifikimin e tyre deri në orën 02:25.



Në ndërkohë po bëhej edhe shënimi i zarfeve me numrat e sallave që do të përmbanin letrat në të cilat do të shënoheshin përgjigjet që do të vlerësoheshin nga lexuesi optik.



(Shënimi i zarfeve me numrat e sallave në të cilat do të mbahet provimi pranues)

Derisa ky proces po vazhdonte, pas disa minutash u vërejt se ishin ngatërruar disa nga këto letra dhe se në 34 zarfe ishin vendosur dokumente të sallave të gabuara, andaj edhe filloi kontrollimi dhe zëvendësimi i tyre.



(Renditja e zarfeve me numrat e sallave përkatëse në të cilat do të mbahej provimi pranues)



(Rishikimi i zarfeve dhe zëvendësimi i tyre me dokumentet përkatëse)

Në orën 03:30, nga kabinetet me anëtarët e komisioneve për përpilimin e pyetjeve për provimin pranues, u sollën testet e formuluara dhe të renditura përmes kompjuterit, për t'i printuar në gjuhën shqipe dhe për t'u përkthyer ato në gjuhën turke dhe boshnjake.



(Shtypjet e para të fletë-provimeve pranuese në gjuhën shqipe)

Printimi i 1721 provimeve pranuese filloi në 03:40, për të cilat u përdorën tre printerë. Zhurma e tyre u dëgjua për disa orë më tej.



(*Procesi i printimit të fletë-provimeve pranuese*)

Përgatitjet finale filluan të bëheshin prej orës 07:20, përveç provimeve pranuese që duhet të printoheshin për gjuhën boshnjake e të cilat nuk arritën të përfundoheshin deri në orën 07:30.



(Në tavolinën përballë është e ulur përkthyesja e gjuhës boshnjake e cila ende nuk e kishte përfunduar përkthimin e provimit pranues)

Në orën 07:30 filloi mbledhja e menaxhmentit me stafin akademik të Fakultetit të Mjekësisë, në të cilin profesorët njoftoheshin se në cilën sallë dhe me cilët kolegë do të ishin në mbikëqyrje gjatë provimit pranues.



Më tutje iu dhanë edhe udhëzime rreth procesit dhe mbarëvajtjes së këtij provimi, i cili kishte gjithsej 29 kryesues të cilët kishin mbi pesë bashkëpunëtorë në ekipin e tyre.


Në orën 07:45 përfundoi procedura e karantinës, kryesuesit e stafit akademik që ishin përcaktuar në salla të ndryshme morën materialet për t'i dërguar në tri lokacionet ku do të mbaheshin provimet pranuese, në sallat e dekanatit të vjetër dhe të ri, në ato të Klinikës së Otorinolaringologjisë (ORL) dhe në ato të Fakultetit Teknik.



(Grumbullimi i zarfeve të sallave të caktuara nëpër kuti të mëdha, për t'i transportuar në objektet ku do të mbahej provimi pranues)

Dekanja tutje tregoi për monitorueset e organizatës ORCA se në orën 20:00 të mbrëmjes, fletat që janë plotësuar nga kandidatët për studentë do të fillonin të kontrolloheshin nga lexuesi optik.

Në orën 08:25, disa kuti që mbanin zarfet me provime pranuese u larguan nga objekti i dekanatit nën përcjellje të Policisë së Kosovës për t'u dërguar në sallat e Fakultetit Teknik, ku edhe do të mbahej një pjesë e provimit pranues.



(*Fillimi i bartjes së kutive me zarfet që përmbanin fletë-provimet pranuese*)



(Bartja e kutive me provime pranuese nga ana e stafit akademik, nën përcjelljen e Policisë së Kosovës)

Kandidatët për studentë filluan të mblidheshin në oborr prej orës 08:15, ndërkohë që në orën 08:50, kandidatëve u lejohej që të hynin brenda objektit por u kërkohej që çantat t'i linin në korridore, ndërkaq tek dera e sallës verifikoheshin nga stafi akademik.



(*Pritja e kandidatëve për studentë para objektit të ri të dekanatit të Fakultetit të Mjekësisë disa minuta para fillimit të provimit*)



(Verifikimi i kandidatëve nga ana e stafit akademik para hyrjes në sallë ku do të mbahej provimi)

Provimi filloi në orën 09:00 të mëngjesit të 5 tetorit, për të zgjatur 90 minuta gjithsej.



(Udhëzimi i kandidatëve nga ana e stafit akademik që të mbajnë distancë me kolegët në vendet ku ulen)

06 tetor 2020 (Një ditë pas provimit pranues)

Të nesërmen pas provimit pranues, prej orës 07:00 do të fillonte kontrollimi manual i fletave të parapara për verifikim nga lexuesi optik, meqenëse sipas dekanes ka pasur raste që lexuesi optik nuk e ka bërë kontrollimin e këtyre fletëve në mënyrë të duhur meqenëse ka pasur raste kur këto fletë janë dëmtuar në çfarëdo mënyre nga kandidatët gjatë testimit.

Ndërkohë që pasdite do të publikoheshin rezultatet preliminare të kandidatëve të cilët kanë kaluar provimin pranues dhe tashmë kanë hyrë në proces për të marrë thirrjen student i Fakultetit të Mjekësisë në Universitetin e Prishtinës.